

**VENDIM**  
**Nr. 753, datë 30.11.2019**

**PËR PËRKRAHJEN SOCIALE DHE FINANCIARE TË FAMILJEVE TË**  
**VIKTIMAVE TË TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Secilës prej familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019 t’i akordohet shuma prej 1 000 000 (një milion) lekësh, në formën e ndihmës financiare.

2. Shpenzimet e varrimit e të ceremonisë mortore, për të gjitha viktimat e tërmetit të datës 26.11.2019, të përballohen nga buxheti i shtetit.

3. Efekti financiar përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**